



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER**

Nr.2511/2 Prot.

Fier, më 16/07/2021

VENDIM Nr.127

Sot, më datë 16/07/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi mora në shqyrtim Proces verbalin e kontrollit aposterior me nr.2511 Prot., datë 11/06/2021 (Për mallin e deklaruar me DAV nr R 10393, datë 26/12/2020) i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit pranë Degës së Doganës Fier, ndaj subjektit “Daris – Lejan” sh.p.k me nipt L94312401O, me seli në Lushnjë (Golem i Madh, Magazine me Nr.Pasurie 33/68, Zona Kadastrale Nr.1789), me administrator z.Albert Isufi, me status në QKB “aktiv”.

KONSTATOVA SE:

Pranë Degës së Doganës Fier, është paraqitur subjekti “Daris – Lejan” sh.p.k me nipt L94312401O, me ushtrim të aktivitetit në Fier, i përfaqësuar nga agjensia doganore “Best Choice”, me për të deklaruar vendosjen në qarkullim të lirë të mallit, me deklaratën doganore IMP- 4 me numër R 10393, datë 26/12/2020, me të cilën ka deklaruar artikullin “Panel diellor për prodhim energjie elektrike”, me peshë neto 8,482 kg, klasifikuar në kodin tarifor *85411000*.

Bazuar në shkresën nr.10305 Prot., datë 09/06/2021 të Drejtorisë së Politikave të Vlerësimit Doganor në Departamentin e Analizave dhe Aposteriorit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me lëndë “Mbi problematikat e vlerësimit”, e administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Fier me nr.2478 Prot., datë 10.06.2021, me anë të së cilës, midis të tjerave, është kërkuar rishikimi i deklaratës doganore të lartpërmendur, Dega e Doganës Fier, ka mbajtur proces – verbalin e kontrollit aposterior me nr.2511 Prot., datë 11/06/2021, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr.2511/1 Prot., datë 11/06/2021, me lëndë “Njoftim për fillimin e procedurës administrative” dhe rezulton nga shërbimi postar (lajmërim marrje me kod bar RR 637 269 653 AA) se subjekti ka marrë dijeni.

Nga kontrolli aposterior i kryer, është llogaritur detyrimi doganor shtesë, bazuar në dosjen e të dhënave të disponueshme, si dhe të dhënat në Data-Base Kombëtar të Vlerësimit Doganor, duke ndjekur radhën e metodave të vlerësimit doganor sipas përcaktimeve në legjislacionin doganor, është kryer rivlerësimi i mallit të deklaruar, bazuar në vlerën 108 \$/copë (duke u bazuar në deklarin doganor me të njëjtën origjinë malli dhe kod tarifor).

Për sa më lart, mbështetur në kreun III “Vlera për qëllime doganore” neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar),V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave,

V E N D O S A :

- Subjekti “Daris – Lejan” sh.p.k me Nipt L943124010, të paguajë detyrimin doganor në shumën **411.654** (Katërqindnjëmbëdhjetëmijë e gjashtëqindpesëdhjetekatër) lekë.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Kontrollit Aposterior të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Daris – Lejan” sh.p.k me nipt L943124010, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Olton Kuqe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.3095/4 Prot.

Fier, më 03/08/2021

V E N D I M - Nr.145

Sot, më datë 03/08/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Procesverbalin e Verifikimit të Kundërvajtjes Administrative me nr. serial 0012081, me nr.3095/1 Prot., datë 22/07/2021, i mbajtur nga Sektorit të Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier, në ngarkim të subjektit “**Mentor Skënder Malaj**” me ID G81231047I, me banim në Fier (“Aleksandër Zaka”, Ndërtesa nr.14, hyrja nr.2),

K O N S T A T O V A S E :

Në zbatim të Ligjit Nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kuadër të bashkëpunimit institucional, nga ana e inspektorëve të autorizuar të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Shtetit Fier, është kryer sekuestrimi i mallit “Duhan i hapur në ambalazhim letër”, në sasinë 30 copë, me peshë 500 gram/pako, në total 15 kg.

Malli është evidentuar me shkresën me lëndë “Proces Verbal kontrolli fizik/verifikimi”, me nr.serial 0002691, nr.3095 Prot., datë 22/07/2021.

Nga ana e Sektorit të Mbikqyrjes Doganore është proceduar me llogaritjen e detyrimit të akcizës së papaguar nga subjekti, si dhe me përpilimin e Proces verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0012081, me nr.3095/1 Prot., datë 22.07.2021, si dhe është tërhequr me shkresën nr.3095/2 Prot., datë 22/07/2021, me lëndë “Proces verbal i kqyrjes dhe marrjes së dokumentacionit”.

Ka rezultuar se nga ana e subjektit, nuk është vepruar në përputhje me legjislacionin e akcizës, pasi është provuar fakti se subjektit, i është gjendur një sasi malli pa pulla fiskale, gjë e cila bie ndesh me nenin 94/1 të Ligjit nr.61/2012. Në përfundim, pas shqyrtimit të plotë të materialit të mësipërm, rezulton e provuar shkelja e kundërvajtjes administrative parashikuar nga Ligji nr.61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

Për sa më sipër, mbështetur në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat Zbatuese të Ligjit “Për Akcizat”, si dhe Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”,

V E N D O S A :

- Subjektit “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, me banim në Fier, t’i sekuestrohet menjëherë malli i pasqyruar në aktet e lartpërmendura (15 kg Duhan në pako 500 gr). Ky mall do të kalojë në konfiskim pas kalimit të afatit të ankimit administrativ ndaj këtij akti administrativ, në zbatim të nenit 11 të Ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe bazuar në nenin 94/1/b,3, të Ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”.
- Subjekti “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, me banim në Fier, të ndëshkohet me gjobë në masën e dyfishit të detyrimit fiskal të papaguar, në shumën **132.000** (Njëqindetridhjetedymijë) lekë, bazuar në nenin 94/1/a të Ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”.
- Për procedim të mëtejshëm, ngarkohen Sektori Mbikqyrjes Doganore, Zyra e Financës, Zyra e Borxhit Doganor, në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore në fuqi.
- Kundër këtij vendimi, subjektit “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, me banim në Fier, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit, duke plotësuar paraprakisht kushtëzimet ligjore të nenit 105 të Ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.2678/4 Prot.

Fier, më 03/08/2021

VENDIM Nr.146

Sot, më datë 03/08/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi mora në shqyrtim Proces verbalin për verifikimin e kundërvajtjes administrative me nr.serial 0012076, Nr.2678/2 Prot., datë 15/07/2021, i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit pranë Degës së Doganës Fier, ndaj subjektit “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, me ushtrim të aktivitetit në Fier (Lagjja "Afrim i Ri", Rruga e Semanit, Pasuria 15/31-ND, kati i dytë), me administrator z.Giovanni Di Girolamo,

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, me ushtrim të aktivitetit në Fier, ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin e regjimit të përpunimit aktiv. Në funksion të këtij autorizimi, për realizimin e kontratave të investimit, nga ana e subjektit, është proceduar me importimin e mallit “pajsje dhe makineri”, duke u përjashtuar nga tvsh.

Nga kontrolli i ushtruar në përfundim të autorizimit, ka rezultuar se nga ana e subjektit, nuk i është dhënë destinacion doganor mallit “pajsje dhe makineri (makina qepëse)”, të cilat kanë marrë përjashtim TVSH-je në vlerën 53,285 lekë, fakt i cili përbën shkelje doganore “kundërvajtje administrative”.

Dega e Doganës Fier, ka proceduar me mbajtjen e akteve shkresore si vijon : Nr.2678 Prot., datë 24/06/2021 me lëndë “Raport paraprak”; Nr.2678/1 Prot., datë 24/06/2021 me lëndë “Raport përfundimtar” dhe më tej, për shkeljen doganore të konstatuar, Grupi i Kontrollit ka vijuar me shkresën nr.2678/2 Prot., datë 15/07/2021, me lëndë Proces verbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative, i cili, i'u është njoftuar nga Dega e Doganës Fier me shkresën tonë Nr.2678/3 Prot., datë 19/07/2021, me lëndë “Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative” dhe rezulton se nuk keni administruar në sekretarinë tonë, brenda afatit ligjor kundërshtimet e mundshme.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Ligjin Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin nr.5, datë 31.03.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën e doganore dhe akcizës”, Udhëzimin Nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

V E N D O S A :

- Subjekti “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, të paguajë detyrimin doganor në shumën totale **53,285** (Pesëdhjetetremijë e dyqind e tetëdhjetepesë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, të penalizohet në shumën **50.000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/a,b të Kodit Doganor, për mosdhënie destinacion doganor në afat mallit.
- Për të proceduar më tej në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ngarkohen Sektori i Mbikqyrjes Doganore, Zyra e Financës dhe Zyra e Borxhit Doganor.
- Kundër këtij vendimi, subjekti kundërvajtës “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, i lejohej të ushtrojë ankim të arsyetuar brenda afatit kohor 30 (tridhjetë) ditor nga marrja dijene e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor dhe garantuar 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor. Në të kundërt, ankimi administrativ nuk do t’iu merret në shqyrtim.

KRYETAR

Olton Kuqe





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.2675/4 Prot.

Fier, më 03/08/2021

VENDIM Nr.147

Sot, më datë 03/08/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi mora në shqyrtim Proces verbalin për verifikimin e kundërvajtjes administrative me nr.serial 0012073, Nr.2675/2 Prot., datë 15/07/2021, i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit pranë Degës së Doganës Fier, ndaj subjektit “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, me ushtrim të aktivitetit në Fier (Lagjja “Sheq i Madh”, zona kadastrale nr. 3981, pasuria nr. 73/20), me administrator z.Ardjan Bishani,

KONSTATOVA SE :

Subjekti “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, me ushtrim të aktivitetit në Fier, ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin e regjimit të përpunimit aktiv. Në funksion të këtij autorizimi, për realizimin e kontratave të investimit, nga ana e subjektit, është proceduar me importimin e mallit “paisje dhe makineri”, duke u përjashtuar nga tvsh.

Nga kontrolli i ushtruar në përfundim të autorizimit, ka rezultuar se nga ana e subjektit, nuk i është dhënë destinacion doganor mallit “paisje dhe makineri”, të cilat kanë marrë përjashtim TVSH-je në vlerën 306,907 lekë, fakt i cili përbën shkelje doganore “kundërvajtje administrative”.

Dega e Doganës Fier, ka proceduar me mbajtjen e akteve shkresore si vijon : Nr.2675 Prot., datë 24/06/2021 me lëndë “Raport paraprak”; Nr.2675/1 Prot., datë 15/07/2021 me lëndë “Raport përfundimtar” dhe më tej, për shkeljen doganore të konstatuar, Grupi i Kontrollit ka vijuar me shkresën nr.2675/2 Prot., datë 15/07/2021, me lëndë Proces verbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative, i cili, i'u është njoftuar nga Dega e Doganës Fier me shkresën tonë Nr.2675/3 Prot., datë 19/07/2021, me lëndë “Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative” dhe rezulton se nuk keni administruar në sekretarinë tonë, brenda afatit ligjor kundërshtimet e mundshme.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar),Ligjin Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin nr.5, datë 31.03.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën e doganore dhe akcizës”, Udhëzimin Nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

V E N D O S A :

- Subjekti “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, të paguajë detyrimin doganor në shumën totale 306,907 (Treqindegjashtëmijë e nëntëqind e shtatë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, të penalizohet në shumën 50.000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/a,b të Kodit Doganor, për mosdhënie destinacion doganor në afat mallit.
- Për të proceduar më tej në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ngarkohen Sektori i Mbikqyrjes Doganore, Zyra e Financës dhe Zyra e Borxhit Doganor.
- Kundër këtij vendimi, subjekti kundërvajtës “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, i lejohej të ushtrojë ankim të arsyetuar brenda afatit kohor 30 (tridhjetë) ditor nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor dhe garantuar 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor. Në të kundërt, ankimi administrativ nuk do t’iu merret në shqyrtim.

K R A J E T A R

Oltion Kuke

